

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-24-5207-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **MEDPLUS SH.P.K.**
NUI **811867441**
Adresa **Rr. Pranvera e Lirisë, p.n., Lebanë**
Vendi **Prishtinë**
Kodi postar **10000**
Numri Telefonit **044640420**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Jeton Prenaj**
Adresa elektronike **medplusks@gmail.com**
Data e parashtrimit të kërkesës **14.06.2024**

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 31.05.2024

Hapja e ofertave, e planifikuar: 21.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.30.05.2024, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt. 21.06.2024.

Ne kemi analizuar dosjen e tenderit, paramasën dhe përshkrimin e çmimeve dhe kemi vërejt se dosja nuk është e përpiluar mirë dhe krijon paqartësi, huti dhe mund të dështojë ky projekt.

Paramasa/përshkrimi i çmimeve siç është hartuar dhe kërkesa që mos të lejohet ofertimi me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore, krijon hapësira për dështim të këtij tenderi.

Tek shumica e pozicioneve kur vendoset çmimi për njësi dhe shumëzohet me sasinë dhe llogaritet përqindja atëherë po del çmimi me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Në shumicën e pozicioneve kur jepet çmimi real i tregut, çmimi i peshuar del me më katër numra pas presjes dhjetore.

Kërkojmë që të analizoni edhe njëherë përshkrimin e çmimeve dhe të korrigjoni përqindjet tek përshkrimi i çmimeve ose të ndryshoni kërkesën në dosje të tenderit dhe të lejoni ofertimin me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore, pasi që siç e kemi analizuar ne, në disa raste del çmimi i peshuar me katër numra pas presjes dhjetore. Nëse nuk ndryshohen këto kërkesa dhe përshkrimi i çmimeve atëherë duhet të siguroheni ju si autoritet kontraktues se kompanitë nuk do të eliminohen nëse çmimi i peshuar del me dy zero pas presjes dhjetore, pra nëse çmimi i peshuar për pozicione del më shumë se dy numra pas presjes dhjetore.

Të paktën të sqarohet ligjërisht qoftë edhe duke kontaktuar KRPP , se a eliminohet për çmim të peshuara 0.00, pra me dy zero pas presjes dhjetore apo kjo rregull vlen vetëm për çmimin për njësi

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit.

Kërkesat dhe përshkrimi i çmimeve bie në kundërshtim edhe me nenin 25 të RRPP Nr.001/2022.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së-qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE MEDPLUS SH.P.K
NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë dhe të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.